

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në botë

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut 20-26.01.2025

Janë testuar gjithsej 341 materiale në Laboratorët ku bëhen analiza molekulare për vërtetimin e pranisë së virusit SARS-CoV-2. Krahasuar me javën që shkoi (n=283) është shënuar një rritje prej 20,5%.

Është regjistruar 1 rast pozitiv, 1 më pak se javën që shkoi.

Tabela 1. Numri i testimeve dhe rasteve pozitive në periudhën nga 20-26.01.2025

Data	Testime	Pozitive	% e rasteve pozitive
20.1.2025	83	0	0,0%
21.1.2025	76	0	0,0%
22.1.2025	49	1	2,0%
23.1.2025	54	0	0,0%
24.1.2025	36	0	0,0%
25.1.2025	24	0	0,0%
26.1.2025	19	0	0,0%
Gjithsej	341	1	Mesatarisht 0.3%

Personi i sëmurë gjatë javësh që shkoi është nga Struga.

Gjatë javës së kaluar (20-26.01.2025) janë regjistruar si të shëruar 3 persona, ndërkohë që është raportuar 1 rast i vdekjes si pasojë e COVID-19, nga Kumanova, i vaksinuar me 2 doza të vaksinës kundër COVID-19, në moshë mbi 60 vjet, me komorbiditete e që ka ndërruar jetë në spital.

GJENDJA ME COVID-19 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT NË VITIN 2025

Gjatë vitit 2025, deri më 26.01.2025, janë regjistruar gjithsej 14 raste me COVID-19. Në muajin janar të vitit 2025 (6) numri i të sëmurëve është për 2,3 herë më i lartë se sa në muajin dhjetor 2024 (n=6).

Gjatë vitit 2025, deri më 26.01.2025, janë testuar gjithsej 1.049 materiale, në laboratorët në të cilët realizohen testime molekulare për prani të SARS-CoV-2 dhe në laboratorët / institucionet shëndetësore në të cilat bëhen testimet e shpejta antigjene.

Vlerësimi i rrezikut

Shkalla e ulët e transmetimit të SARS-CoV-2, rënia e numrit të raportimeve dhe testimeve ndikon në aftësinë për vlerësimin e gjendjes epidemiologjike. Popullata e EU/EEA në përgjithësi ka një nivel të konsiderueshëm të imunitetit hibrid (vaksinim/vaksinim me booster doza), që ofron një mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes.

Personat mbi 60 vjet janë më të rrezikuar nga pasqyra e rëndë e sëmundjes.

Hospitalizimi i personave me COVID-19 të konfirmuar, pranimet në kujdesin intensiv dhe vdekjet mbeten në nivel të ulët në vendet e BE-së. Këto të dhëna nuk janë të disponueshme në R. e Maqedonisë së Veriut.

Edhe pse numri i të sëmurëve me COVID-19 në javë po shënon rënie, duke pasur parasysh se fillon periudha e qarkullimit të shtuar të viruseve respiratore në hemisferën veriore, ekziston rreziku që aktiviteti i SARS-CoV-2 të rritet, gjë që e thekson nevojën e vazhdueshme për mbikëqyrje (epidemiologjike dhe virologjike) në nivel kombëtar dhe rajonal.

Masa të rekomanduara për parandalim dhe kontroll

Rekomandohet ndjekja e masave themelore për parandalimin e COVID-19 dhe sëmundjeve të tjera respiratore.

Vaksinimi mbetet si masë specifike që mundëson mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes, edhe pse ky efekt mbrojtës me kalimin e kohës dobësohet. Mbetet rekomandimi për vaksinimin e personave me rrezik të lartë nga format e rënda të sëmundjes (siç janë personat më të moshuar).¹

Shkup, 27.01.2025

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse

Instituti i Shëndetit Publik

¹ <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/2024-WCP-0039%20Final.pdf>